



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 42/2015

Prishtinë, më 14.12.2015, në orën 21:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavljeviq, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi dhe Blerim Grainca, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Besim Beqaj, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.12.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligji Nr. 05/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-115;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Miratimi i rendit të ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 8.12.2015

Procesverbali i mbledhjes së datës 8.12.2015, u hoq nga rendi i ditës që të miratohet në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-115

Kryetari Muhamet Mustafa tha se sot Kuvendi me shmangie nga Rregullorja vendosi që ky projektligj të miratohet në dy lexime. Në bazë të debatit në parim kur është shqyrtuar projektligji, shërbimi profesional i Komisionit i ka hartuar amendamentet, si dhe i ka harmonizuar me propozimet e deputetit Raif Qela, i cili i ka dërguar me email.

Amendamenti 1

Neni 1, riformulohet si vijon:

Qëllimi i këtij ligji është plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit bazik Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 19 / 21 shtator 2011), i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Nenin 4 të Ligjit Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 25 / 07 shtator 2012), më qëllim të funksionalizimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm “Agjencia”).

Pas debatit Komisioni nuk e përkrahu amendamentin 1.

Amendamenti 2

Neni 2, riformulohet si vijon:

Neni 12 i Ligjit bazik, riformulohet si vijon:

Neni 12

1. Bordi përbëhet nga 8 (tetë) drejtorë.
2. Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë, emëron drejtorët e Bordit, duke përfshirë një përfaqësues nga komunitetet jo-shumicë, si dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve.
 - 2.1 Përfaqësuesi nga komuniteti jo-shumicë në Bordin e Drejtorëve duhet të jetë nga komuniteti serb, së paku çdo të dytin mandat.
 - 2.2 Përfaqësuesi nga komuniteti jo-shumicë në Bordin e Drejtorëve duhet të jetë nga komunitetet e tjera jo-shumicë në Kosovë, së paku çdo të tretin mandat.
3. Kuvendi, me propozimin e Qeverisë, nga radhët e anëtarëve të Bordit cakton kryesuesin e Bordit.
4. Bordi, emëron zëvendëskryesues të Bordit, njërin prej anëtarëve të tij.

5. Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet drejtor nëse:

5.1. Është dënuar për kryerje të ndonjë vepre penale, me përjashtim të veprave të lehta penale të kryera nga pakujdesia, nga lajthimi faktik apo lajthimi juridik dhe për të cilat i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje jo më shumë se 6 muaj, ose dënim me kusht;

5.2. Është përjashtuar ose suspenduar nga ushtrimi i mëtutjeshëm i profesionit të tij për shkak të shkeljeve të rënda profesionale në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5.3. Ka interes apo pretendim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në apo kundër një ndërmarrje ose në një person apo subjekt i cili pretendon apo pohon një interes apo pretendim; dhe

5.4. Ka interesa ose angazhohet në veprimtari të cilat janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15 të këtij ligji.

6. Në rast të inicimit të çfarëdo procedure hetimore ndaj ndonjërit prej drejtorëve të Bordit, Kuvendi i Republikës së Kosovës e shqyrton nevojën e suspendimit apo jo të tij/saj nga Bordi i Drejtorëve.

7. Për të pasur të drejtën e zgjedhjes si drejtor, personi duhet të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në fushën e administratës publike, drejtësi, kontabilitet, financa dhe menaxhim të ndërmarrjeve.

8. Bordi emëron Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit.

9. Drejtori menaxhues dhe dy zëvendës drejtorët menaxhues nuk janë anëtarë të Bordit.

Raif Qela tha se e kam propozuar këtë amendament, ku në paragrafin 2, të nenit 12 është harmonizuar me Kushtetutën, ku në vend të “komuniteti jo-shqiptar” është zëvendësuar në “komunitet jo-shumicë”; si dhe kam propozuar dy nënparagrafë për të sqaruar formën e rotacionit se si komunitet do të përfaqësohen. Ndërsa, të paragrafi 5.1 kam menduar se do të evitohej çdo zbrastirë ligjore për një kandidat sa i përket të kaluarës së tij; ndërkaq të 5.2 është fshirë testi i panevojshëm si “standardet ndërkombëtare”; është shtuar, po ashtu, paragraf i ri 6 që nëse ndaj një drejtori të Bordit niset ndonjë hetim, të niset procedura e suspendimit nga ana e Kuvendit.

Komisioni, e përkrahu propozimin e deputetit Qela, pa shtesën e nënparagrafëve 2.1 dhe 2.2; pa paragrafin 6; si dhe riformuloj nënparagrafin 5.1 si vijon: “5.1. është dënuar për kryerje të ndonjë vepre penale.”

Sala Berisha – Shala, propozoi që fjalia në fund të paragrafit 7 “dhe menaxhim të ndërmarrjeve.” të zëvendësohet me “punë menaxheriale”.

Komisioni e përkrahu propozimin e deputetes Berisha – Shala.

Amendamenti 3

Neni 3, riformulohet si vijon:

Neni 3

1. Neni 14, paragrafi 4 i Ligjit bazik riformulohet si vijon:
4. Bordi ka kuorum nëse janë të pranishëm së paku 5 (pesë) drejtorë.
2. Neni 14, paragrafi 7 i Ligjit bazik riformulohet si vijon:
7. Për vendimet të cilat duhet të bëhen sipas nenit 15, nevojitet shumica e kualifikuar, vendimi do të merret me së paku 5 (pesë) vota për.
3. Neni 14, paragrafi 9 i Ligjit bazik fshihet.

Raif Qela tha në paragrafin 7 vetëm të zëvendësohet “për” me “pro”.

Komisioni e përkrahu propozimin e deputetit Qela.

Amendamenti 4

Neni 4 riformulohet si vijon:

Neni 4

Neni 15, nën paragrafi 2.3. i Ligjit bazik riformulohet si vijon:

2.3. Emërimi apo shkarkimi i drejtorit menaxhues, zëvendës-drejtorit menaxhues ose të ndonjë zyrtari tjetër.

Komisioni e përkrahu amendamentin 4.

Amendamenti 5

Neni 5, riformulohet si vijon:

Neni 5

Neni 31, paragrafi 5 i Ligjit bazik fshihet.

Komisioni e përkrahu amendamentin 5.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Amendamente i Projektligjit Nr. 05/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-115.

2. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme, sipas procedurës së rregullt.

4 Të ndryshme

Çështje vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 21:20.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa